



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K. të datës 20.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **Hedhet poshtë si e palejuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albi Company” e datës 20.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Albi Company” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Albi Company” (tutje “parashtruesi”) me datë 20.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Përmes nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet sipas afatit vijues "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore". Në rastin konkret data e hapjes së ofertave është përcaktuar me 20.09.2023 sipas formularit për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të datës 25.09.2023 në ora 14:00. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim. Në anën tjetër kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është ngarkuar në sistemin e prokurimit me datë 20.09.2023 në ora 11:34. Rrjedhimisht ndërmjet datës së kërkesës për rishqyrtim dhe datës për hapjen e ofertave janë vetëm katër (4) ditë respektivisht më pak sesa pesë (5) që kërkohen sipas nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të RRPP.

Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 të RRP përcaktohet se "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj RRPP". Tutje përmes nenit 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) përcaktohet se "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me anë të një vendimi, mund të refuzojë kërkesën për shqyrtim sipas Nenit 62 të kësaj rregullore kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.